

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Balla-opozitës: Lërimi folklorizmat, sot duhet të jemi më të bashkuar se kurrë, andej dhe këndej kufirit
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/balla-opozites-lerini-folklorizmat-sot-duhet-te-jemi-me-te-bashkuar-se--i586640
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 09:40:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 09:40:11 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	341de28b6133cb8a95ec9fb523a1614b38e8dde5a9aea9d3c6e4970c31fabdad
TEKSTI	289eadcd1d597b02f94588673c7dca2e862d87f6b308489bf0a6af88d4b8688c9
PAMJA	4527194d2473ca09356858d42a1eeab87a13e35497cc45af40e775f13c33aec3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9fc2658384307138af2a4141a514fb1087071a6dac185127563a13f992e73ca8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9fc2658384307138af2a4141a514fb1087071a6dac185127563a13f992e73ca8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by [Kontakt](#)



English



ie [Sekuestrohen dy celulare te paligjshem ne burgje, procedohen 8 personaNga perdorimi ne pronesi: Kadastra mbylli procesin per 522 Ha toke bujqesore ne Shijak41 vepra fundit](#)

Balla-opozitës: Lërimi folklorizmat, sot duhet të jemi më të bashkuar se kurrë, andej dhe këndeje kufirit



17 Shtator 2026, 11:40Politika TEMA



Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla u ndal në Kuvend të deklarata për Kosovën, duke thënë se mazhoranca dhe opozita kishin rënë dakord në Konferencën e Kryetarëve që qëndrimi të mbahej në mënyrë institucionale nga kryetari i Kuvendit.

“Unë kam heshtur sot, të them të drejtën. Besoj se të gjithëve na plas shpirti këtu për t’i thënë ca fjalë”, tha Balla, ndërsa kundërshtoi që deklarata për Kosovën të kushtëzohej nga mungesa në sallë e deputetit Agron Shehaj.

“Na dalin edhe na thonë ‘mos votoni deklaratën për Kosovën’, se na mungon Agron Shehaj. Do të plasë dy herë shpirti, jo një herë”, u shpreh ai.

Balla më pas u përqendrua te debatet procedurale në seancë, duke kërkuar që çështjet për të cilat Kuvendi ka votuar të mos rihapen sërish për diskutim.

“Mund të jemi i vetmi parlament në botë që bëjmë diskutimin, shkojmë në votim dhe, pasi bëjmë votimin, i kthehemi edhe një herë diskutimit”, tha Balla.

Duke iu referuar kërkesës së PD-së për heqjen nga rendi i ditës të projektligjit për magistratët, Balla tha se kërkesa ishte diskutuar dhe rrëzuar me votë dhe kërkoj nga drejtuesi i seancës që të mos lejojë rihapjen e së njëjtës çështje.

“Pasi bëhet votimi, nuk ka më diskutim dhe prapë të hedhim në votim atë që rrëzuam në votim. Duhet të jemi pak seriozë”, deklaroi Balla.

Fjala e plotë:

Mund të jemi i vetmi parlament në botë që bëjmë diskutimin, shkojmë në votim, mbasi bëjmë edhe votimin, i themi edhe një herë diskutimit. Tani, për çështjen që diskutoi zonja deputete, kishte një kërkesë nga grupi parlamentar i Partisë Demokratike. U çua kryetari i grupit parlamentar të Partisë Demokratike pa i hequr ekspertizën... E sqaroi më së miri. Në vlerësimin e çështjeve që ngri. Pra, pse kjo çështje duhet të ikte nga rendi i ditës.

Tani, u ngrita dhe unë në emër të kësaj pjesës së sallës, sqarova pse kjo çështje nuk duhet të iki nga rendi i ditës. Tani kashtë mbi tjegulla del një tjetër dhe thotë “hiqeni nga rendi i ditës”. Pasi ne kemi bërë votimin, tani duhet të jemi çik serioz, zoti kryetar. Pra, një çështje praktika parlamentare, britanikët na e kanë mësuar këtë, këtë formë parlamentarizmi. Pasi bëhet votimi, nuk ka më një diskutim, dhe prapë tani të hedhim në votim atë që rrëzuam në votim. Dhe prandaj, zoti kryetar, në momentin që juve ju kërkohet, më falni, se nuk dua t’ju kërkohet fjala për procedurë, për një çështje, në momentin që ajo çështje është ezauruar ndërpritet fjala, kalohet tek një folës tjetër.

Nëse ka një çështje për procedurë, deri tani nuk ka pasur asnjë diskutim për procedurë, asnjë. Deri shkuam në pikën që, meqenëse na mungon Agron Shehaj, ne nuk duhet të shprehemi për çlirimtarët. Se na mungon Agron Shehaj në sallë, është hall i madh. Të lutem shumë, kryetar, besoj që po afron momenti që duhet të kemi atë deklaratën gati, që diskutuam, unë kam heshtur sot, të them të drejtën, besoj se të gjithë të tjerët na plas shpirti këtu për t’i thënë ca fjalë. Por atë vendim dje, po, e kemi dakordësuar në konferencë të kryetarëve që do flisni ju, në emrin tonë të gjithëve, për të qenë institucional, për të qenë serioz. Na dalin edhe na thonë “mos votoni deklaratën për Kosovën”, se na mungon Agron Shehaj. Do të plasi dy herë shpirti, jo një herë.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Pagat e magjistratëve/ Rrëzohet kërkesa e PD për tërheqjen e draftit të PS! Bardhi: Rrezikojmë të shkelim Kushtetutën! Balla: Hipokrizi!](#)

11:10 Politika / 1 koment

[Shqipëria dënon vendimin e Hagës/ Deklaratë e përbashkët në Kuvend kundër dënimit të ish-krerëve të UÇK-së \(VIDEO\)](#)

10:47 Politika / 3 komente

[Presidenti Begaj dekreton Ervin Demon si ministër të Brendshëm](#)

10:35 Politika



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.